

Mekanizmat për Financimin e Mediave në Gjuhët e Pakicave Etnike



SQI

Rreth projektit:

Projekti "Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave – JUFREX" promovon lirinë e shprehjes dhe lirinë e medieve në vendin tonë dhe kontribuan në përmirësimin e zbatimit të standardeve evropiane në këtë fushë.

Duke u bazuar në rezultatet dhe përvojën e fazës së mëparshme të programit, projekti do të vazhdojë të punojë me një varg aktorësh, përgjegjës për zbatimin e këtyre standardeve, siç janë: gjyqtarët, prokurorët, avokatët, policët, përfaqësuesit e autoriteteve rregullatore të medieve, gazetarët, studentët dhe aktorët tjerë të medieve.

JUFREX është pjesë e "Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë II" - një nismë bashkëpunimi e bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe zbatuar nga Këshilli i Evropës, e cila synon të ndihmojë përfituesit në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, që të jenë në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian në kuadër të procesit të zgjerimit, sipas rastit.

Ky raport është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të donjërës palë.

- Qëndrueshmëria financiare e mediave në përgjithësi është e vështirë, me theks të veçantë tek mediat lokale dhe të komuniteteve të ndryshme etnike jo shumicë të cilat e kanë audiencën më të vogël.

Mediat lokale të komuniteteve jo shumicë në përgjithësi varen nga përkrahja e donatorëve ndërkombëtarë, rrallë herë nga autoritetet lokale ku ato operojnë, dhe shpesh edhe bazohen në lidhjet e tyre politike.

Si rrjedhojë kjo ndikon negativisht në ruajtjen e profesionalizmit dhe paanshmërisë në raportimin e tyre.

Prandaj, duhet të ketë një përkrahje nëpërmjet ekspertëve që të facilitohen këto media që të mund të diversifikojnë të ardhurat e tyre në mënyrë që të shfrytëzohen edhe mekanizmat online për qëndrueshmëri financiare.

- Mediat e minoriteteve, funksionojnë si biznese apo organizata jo qeveritare (OJQ). Në këtë aspekt për ato media që funksionojnë si biznese paraqiten vështirësi në përfitimin e donacioneve nga ana e donatorëve pasi që shumica prej tyre i dedikojnë donacionet për OJQ.

Po ashtu vështirësi për këto media është edhe tregu shumë i limituar apo edhe inekzistent. Kjo pasi që shumica e reklamuesve tentojnë të reklamojnë në media nacionale.

Nga ana tjetër është pak më e lehtë për mediat që funksionojnë si OJQ, pasi që kanë gamë më të gjerë të donatorëve.

Por mediat që funksionojnë si OJQ-ve janë në garë me OJQ të Shoqërisë Civile të cilat janë më të përgatitura për përgatitjen e aplikacioneve, gjë që nuk e kanë mediat lokale dhe të komuniteteve.

Prandaj rekomandohet bashkëpunim i OJQ-ve të Shoqërisë Civile me mediat lokale në mënyrë që të komplementohen funksionet e tyre. OJQ-të të Shoqërisë Civile kanë nevojë për promovimin e aktiviteteve të tyre në ato lokalitete në të cilat veprojnë e mediat lokale dhe të komuniteteve që operojnë si OJQ mund të ofrojnë këto shërbime.



- Në vendin tonë janë të licencuara 19 media televizive, ku pesë (5) nga to ofrojnë shërbime mediale televizive në gjuhën serbe. Nga ana tjetër janë 89 radio nga të cilat 22 janë serbe, tri (3) boshnjake, dy (2) gorane dhe një (1) turke.

Të gjitha këto media duhet të paguajnë një shumë të caktuar për licencim dhe marrje të frekuencave. Shumat variojnë për nga mbulueshmëria lokale, rajonale apo nacionale me frekuenca. Duke pasur parasysh vështirësitë e mediave që mezi arrijnë të funksionojnë si rrjedhojë e vështirësive në financim dhe si pasojë e pandemisë Covid-19, vitin e kaluar Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) i ka bërë kërkesë Qeverisë që të hiqen të gjitha tarifat e mediave vjetore, një gjë e tillë nuk është aprovuar nga Qeveria.

Nga ana tjetër KPM, në vitin 2019 ka hartuar dhe miratuar një rregullore për specifikat dhe metodën e përkrahjes dhe ndarjes së mjeteve për mediat në mënyrë që të promovohet kualitet, transparencë dhe përmbajtje edukative dhe informuese për qytetarët në të gjitha gjuhët.

Për të funksionalizuar këtë rregullore, nevojitet që Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave të përfshijë një provizion që mjetet që grumbullohen si pjesë e licencimit dhe ndarjes së frekuencave, një pjesë e tyre të shkojë për përkrahje financiare për mediat lokale dhe të komuniteteve.

Prandaj, rekomandohet që të llobohet nga vetë mediat e komuniteteve jo shumicë, përfaqësuesit e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian, në mënyrë që ky provizion të përfshihet në ligjin që është në ndryshim dhe pritet të miratohet në gjashtë mujorin e parë të 2022.

- Zhvillimet dhe përparimet teknologjike të viteve të fundit kanë vështirësuar zhvillimin e mediave lokale dhe të komuniteteve jo shumicë që të jenë në hap me avancimet teknologjike.

Këto vështirësi janë si rrjedhojë e kapaciteteve të tyre financiare. Shto këtu faktin që ballafaqohemi me një periudhë të prolifirimit të dezinformatave dhe lajmeve të rrejshme, është me rëndësi të kemi media lokale dhe të komuniteteve të cilat promovojnë dhe mbulojnë zhvillimet në mënyrë të drejtë, të pa anshme dhe profesionale.

Në kuadër të nismave për mediat në gjuhë të minoriteteve është promovuar rjetëzimi i mediave në gjuhë të minoriteteve. Si rrjedhojë kemi rjetëzime të mediave serbe TV Mreza dhe KOSMA.

Prandaj mediat lokale dhe ato të komuniteteve është me rëndësi që të krijojnë rjetëzime dhe bashkëpunime në mes vete dhe mediave nacionale në mënyrë që të këmbëjnë informata, lajme, përmbajtje programore, etj. Nëpërmjet kësaj mënyre këto media mund të tërheqin më shumë reklama dhe financime.

- Është në interes të institucioneve shtetërore ruajtja dhe promovimi i gjuhëve, kulturave dhe traditave të komuniteteve të ndryshme në vendin tonë. Ekzistojnë dokumente të ndryshme strategjike siç janë Strategjia për Komunitete, dhe strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare.

Në vitet e kaluara, si pjesë e këtyre dokumenteve strategjike, kanë qenë të planifikuara ndarja e mjeteve për promovimin dhe financimin e mediave të komuniteteve jo shumicë. Ndërsa në vitet e fundit ky planifikim është hequr nga dokumentet e rishikuara.

Prandaj rekomandohet që të rikthehen dispozitat brenda ligjeve për planifikimin e përkrahjes financiare të mediave lokale, posaçërisht për mediat e komuniteteve jo shumicë në vendin tonë.



Përfundimet dhe rekomandimet

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, me mbështetjen e Projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias (JUFREX)" ka organizuar tryezën e diskutimit mbi mekanizmat specifik për financimin apo mbështetjen financiare të mediave private apo jo-fitimprurëse të cilat publikojnë përmbajtje në gjuhët e pakicave të ndryshme etnike.

Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve i miratuar në vitin 2006, përcakton se gjuha Shqipe dhe Serbe janë gjuhë zyrtare dhe për këtë arsye të gjitha institucionet dhe ofruesit e shërbimeve publike në vend janë të obliguar që të sigurojnë përdorimin e tyre të barabartë në sistemin gjyqësor, institucione shtetërore dhe komunale, ndërmarrje publike, në media, arsim, shërbime sociale dhe në sektorin privat.

Duke qenë se kjo e drejtë është ofruar nga kuadri ligjor dhe institucional, nevoja për të pasur media të qëndrueshme dhe të mirë-formuara të pakicave në shoqërinë tonë është jetike. Kjo ngjarje kishte për synim që brenda komunitetit të diskutohen sfidat dhe zgjidhjet e mundshme mbi këtë çështje.

